



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE (KQZ), në mbështetje të nenit 64, paragrafi 2 nën paragrafi 2.1. dhe 2.2, neni 5 paragrafi 5 dhe 6, neni 127 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), si dhe nenit 4, paragrafi 4.4, nenit 11, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës (LZL), me datën 21.08.2024, miraton këtë:

RREGULLORE ZGJEDHORE NR. 15/2024
ZGJEDHJET E PARAKOHSHME DHE TË JASHTËZAKONSHME

Neni 1
Qëllimi

Kjo Rregullore përcakton afatet kohore për zbatimin e aktiviteteve zgjedhore, pas publikimit të datës së zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, kuvendin komunal dhe zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar komune.

Neni 2
Përcaktimi i afateve kohore

1. Zgjedhjet e parakohshme dhe të jashtëzakonshme rregullohen me ligje dhe Rregulloret e KQZ sikurse edhe zgjedhjet e rregullta, përveç përcaktimit të afateve kohore proporcionale për veprimet e përcaktuara në këtë nen, varësisht nga afati i përcaktuar për zgjedhjet respektive.
2. Një ditë pas shpalljes së datës së zgjedhjeve të parakohshme dhe/apo të jashtëzakonshme, KQZ nxjerr vendim për caktimin e afateve kohore dhe planin e aktiviteteve të zgjedhjeve për:
 - 2.1. Pranimin e ekstraktit të parë të Regjistrimit Civil nga Agjencia e Regjistrimit Civil (ARC);
 - 2.2. përcaktimin e kufizimit të shpenzimeve për fushatën zgjedhore;

- 2.3. emërimin e Komisioneve Komunale Zgjedhore (KKZ);
- 2.4. planin e rekrutimit të stafit zgjedhor;
- 2.5. planin e informimit publik;
- 2.6. planin e trajnimit;
- 2.7. funksionalizimin e Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve (QNR);
- 2.8. publikimin e Qendrave të Votimit (QV);
- 2.9. themelimin funksionalizimin e Qendrave Komunale të Numërimit (QKN);
- 2.10. periudhën e kundërshtimit dhe konfirmimit të listës së votuesve;
- 2.11. periudhën e aplikimit dhe regjistrimit për votim jashtë Kosovës;
- 2.12. deklarin e partive politike të regjistruara për mos pjesëmarrjen në zgjedhje;
- 2.13. deklarin e koalicioneve të partive politike për zgjedhje;
- 2.14. certifikimin e subjekteve politike dhe kandidatëve;
- 2.15. korrigjimin e listave dhe zëvendësimin e kandidatëve;
- 2.16. periudhën e votimit jashtë Kosovës;
- 2.17. tërheqjen e shortit për renditje në fletëvotim;
- 2.18. fushatën zgjedhore si dhe afatet për tubimet e fushatës zgjedhore;
- 2.19. regjistrimin dhe Votimin e Personave me Nevoja të Veçanta (VNPV);
- 2.20. emërimin e Këshillave të Vendvotimeve (KVV);
- 2.21. emërimin e ekipeve të numërimit në QKN;
- 2.22. emërimin e Këshillave të Vendvotimeve (KVV) në përfaqësitë diplomatike;

- 2.23. periudhën e aplikimit dhe akreditimit të vëzhguesëve;
- 2.24. publikimin e raporteve financiare të fushatës;
- 2.25. certifikimin e Listës përfundimtare të votuesve;
- 2.26. afatet e aktiviteteve tjera të përcaktuara me ligj dhe rregulloret zgjedhore.

Neni 3
Dispozita kalimtare dhe përfundimtare

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore shfuqizohet Rregullorja Nr. 15/2023 për Zgjedhjet e Parakohshme, e datës 09.03.2023.

Neni 4
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga KQZ.

Kryesues
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi